



## UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NE RAJON

### KËRKESË PER OFERTË

**“Për kontraktimin e një Grupi artistik, që do të sigurojë shërbimin e performancës muzikore gjatë pritjes zyrtare për hapjen e sezonit turistik të qyteteve shqipfolëse organizuar në datën 10.06.2021, ora 19:00-21:00 nga UBSHR”**

UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON, në zbatim të fazës së dytë të projektit të Turizmit Rajonal, kërkon të kontraktojë 1 (një) grup artistik të kualifikuar për të performuar muzikë të vjetër shqiptare live gjatë pritjes. Në datë 10.06.2021, UBSHR do të organizojë një pritje zyrtare me të ftuar nga Rajoni, ku do hapet sezoni turistik në të gjitha qytetet anëtare. Për këtë event kërkohet performanca e një grupi artistik që do të luajë muzikë të vjetër shqiptare gjatë mbremjes.

#### Detyrat

- Të luajë muzikë live gjatë eventit me kohëzgjatjen 19:00-21:00.
- Përcaktimi i repertorit të grupit/bandës muzikore për t'iu përshtatur konceptit dhe qëllimit që ka ky event.

#### Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët.

#### Kriteret për përzgjedhjen

1. Eksperienca profesionale në treg
2. Kostoja më e ulët e shërbimit

#### Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. CV profesionale
2. Kopje ID/Pasaportë ose ekstrakt nga QKB.
3. Oferta financiare

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave:** 29.05.2021 ora 11:00.

Cdo person i interesuar mund të dërgojë dokumentat mbi këtë procedurë përmes komunikimit elektronik në adresën email [ubshr@tirana.al](mailto:ubshr@tirana.al), ose duke u paraqitur pranë zyrave të Unionit në adresën *Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18.*

**DREJTORI EKZEKUTIV**  
Andriola Kambo

